



QYTETI I SHKUPIT

Në bazë të Programit të aktiviteteve nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor në territorin e Qytetit të Shkupit për vitin 2025 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 16/24), dhe në lidhje me Nenin 4 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e subvencionimit të qytetarëve për zëvendësimin e çative të asbestit nr. 08 – 10229/1 datë 17.09.2024, Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE për subvencionimin e qytetarëve për zëvendësimin e çative të asbestit për vitin 2025

1. Qëllimi i Thirrjes publike

1.1. Lëndë e thirrjes publike është ndarja e subvencionimit individual për qytetarët, banorë të qytetit të Shkupit, për zëvendësimin e çative të asbestit në vitin 2025.

1.2. Thirrja publike do të zgjasë nga dita e shpalljes deri më 15 tetor 2025 ose deri në shterimin e mjeteve të parashikuara për këtë qëllim (aktivitetet e thirrjes publike duhet të përfundojnë plotësisht deri më 15 tetor 2025).

1.3. Mjetet që do të subvencionojë Qyteti i Shkupit janë maksimumi 50% e vlerës së investimit, por jo më shumë se 100.000,00 denarë, për person/aplikant, nga vlera e përgjithshme e vlerës së nevojshme për zëvendësimin e çatisë së asbestit, duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat personale.

1.4 Mjetet financiare janë siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2025 në Programin R1, zëri 464, nënzëri 464990, në vlerë prej 1.000.000,00 denarë.

2. E drejta për pjesëmarrje në Thirrjen publike

2.1 Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen Publike kanë qytetarët, banorë të qytetit të Shkupit, (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisela Voda, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare), të cilët do t'i zëvendësojnë çatitë e asbestit, plotësojnë kushtet e Thirrjes Publike dhe depozitojnë dokumentacionin e nevojshëm.

3. Kushte që duhet t'i plotësojë aplikanti

Aplikanti duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Të jetë banor i qytetit të Shkupit, (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisela Voda, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare).
- Të pranojë të zëvendësojë çatinë e asbestit dhe të pranojë të marrë pjesë me mjetet e veta për një pjesë të vlerës së përgjithshme për zëvendësimin e çatisë së asbestit.
- Të mos jetë përfitues i mëparshëm i subvencioneve për të njëjtin qëllim nga komunat tjera në qytetin e Shkupit.
- Zëvendësimi i çatisë së asbestit mund të kryhet vetëm brenda kornizës së çatisë ekzistuese.
- Të jetë pronar i objektit banesor individual (shtëpi) që ka çati ekzistuese azbesti në datën e depozitimit të kërkesës.
- Të lidhet Kontratë me kontraktuesin për zëvendësimin e çatisë së asbestit.
- Pas përfundimit të punimeve të depozitojë:
 - Deklaratë nga kontraktuesi për punën e përfunduar të vërtetuar nga ana e tyre,
 - Formulari i identifikimit dhe transportit për mbetjet dhe Faturë peshimi nga NP deponia "Drisla"
 - Faturë në origjinal të vërtetuar nga kontraktuesi.

4. Mënyra e aplikimit dhe dokumentet e nevojshme për pjesëmarrje në Thirrjen publike

4.1. Për kompensimin e një pjesë të shpenzimeve dhe për të vërtetuar se janë plotësuar kushtet për pjesëmarrje në Thirrjen publike, aplikanti është i detyruar të depozitojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Aplikimi i plotësuar – formulari i nënshkruar nga pronari i objektit për banim individual (shtëpi);
- Deklaratë e noterizuar* me të cilën pranon se të dhënat e tij personale mund të përdoren vetëm për realizimin e së drejtës së subvencionimit dhe se është pajtuar me kushtet e nënpikave 1, 2, 3, 4 dhe 5 nga pika 3;
- Certifikata e pronësisë që vërteton pronësinë (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj, depozitohet në origjinal ose kopje të noterizuar);
- Fotografi e çatisë ekzistuese prej asbesti me datën e depozitimit të kërkesës;
- Kontratë e lidhur me kontraktuesin për zëvendësimin e çatisë prej asbesti
- Pas marrjes së Njoftimit për përfituesin potencial të subvencionimit dhe pas përfundimit të punimeve, aplikanti duhet të depozitojë:
 - Deklaratë nga kontraktuesi për punët e kryera të vërtetuara nga ana e tyre,
 - Faturë në origjinal të vërtetuar nga kontraktuesi,
 - Formulari i identifikimit dhe transportit të mbetjeve, me bashkëngjitjen – Fletë pranimi nga peshimi, që jepet nga NP deponia “Drisla”,
- Kopje e llogarisë së transaksionit të pronarit të shtëpisë (vetëm llogaria personale e aplikantit, dhe jo e autorizuar nga një person i tretë).

Vërejtje:

- Kërkesa do të publikohet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk dhe e njëjta duhet të plotësohet, çdo lloj Kërkese tjetër nuk do të pranohet;
- Deklarata do të publikohet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk dhe do të duhet të plotësohet dhe noterizohet, çdo lloj tjetër deklarate tjetër nuk do të pranohet;
- Zëvendësimi i çatisë së asbestit të realizohet në përputhje me rregullativën pozitive ligjore;
- Mënjanimi dhe deponimi i pllakave nga asbesti - çimentoja dhe mbetjet e tjera ndërtimore në deponi duhet të realizohet në përputhje me dispozitat ligjore ekzistuese dhe për këtë është e nevojshme të angazhohet subjekt që posedon licencë për të punuar me këtë lloj mbetjeje të rrezikshme.

4.2 Aplikanti mund të fillojë me zëvendësimin e çatisë së asbestit, pasi të ketë pranuar më parë Njoftimin për përfitues të mundshëm. Zëvendësimi i çatisë së asbestit duhet të përfundojë jo më vonë se data **14 (katërmëdhjetë) nëntor 2025**, gjë për të cilën është i detyruar të depozitojë si dëshmi dokumentet nga pika 4, nënpika 4.1, alineja 6.

4.3 Dokumentacionin e nevojshëm, aplikantët e depozitojnë pranë Komisionit nëpërmjet Arkivit të Qytetit të Shkupit (baraka 16) në zarf të mbyllur me shënimin: Drejtuar Sektorit për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor - Komisioni për ndarjen e subvencioneve për zëvendësimin e çative të azbestit, çdo ditë pune nga e hëna deri të premten, nga ora 08:30 deri në orën 15:00.

4.4 Një person mund të parashtrojë vetëm një kërkesë për subvencione.

4.5 Kërkesat e pranuar në arkivin e Qytetit të Shkupit do të regjistrohen me kohën e saktë të depozitimit (data, ora dhe minuta) dhe do të shqyrtohen sipas datës dhe kohës së mbërritjes, dhe pagesa e mjeteve do të pasojë pas përfundimit të plotë dhe kontrollit të aktiviteteve të kryera.

5. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

5.1 Kryetarja e Qytetit të Shkupit formon Komisionin për realizimin e Thirrjes publike i cili do ta zbatojë procedurën në këto faza:

- në fazën e parë, Komisioni shqyrton kërkesat e pranuara sipas datës dhe orës së mbërritjes,
- në fazën e dytë, Komisioni kryen kontroll të detajuar të dokumentacionit të paraqitur dhe kryen inspektimin në terren për të përcaktuar besueshmërinë e dokumentacionit të depozituar.
- në fazën e tretë, Komisioni përgatit listën e aplikantëve të mundshëm dhe njofton aplikantët, të cilët plotësojnë kushtet sipas thirrjes, me qëllim për të vazhduar realizimin e mëtejshëm të procedurës. Për aplikantët që nuk plotësojnë kushtet e fazës së parë dhe të dytë, përgatit njoftim për mosmiratim.
- në fazën e katërt, pas marrjes së Deklaratës nga kontraktuesi për punët e kryera, të vërtetuar nga ana e tyre, fatura në origjinal e vërtetuar nga kontraktuesi me bashkëngjitjen - Formulari i identifikimit dhe transportit të mbetjeve si dhe Fletëpranimi nga peshimi nga NP deponia "Drisla", Komisioni shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e pranuar dhe për aplikantët që plotësojnë kushtet sipas Thirrjes publike, Komisioni kryen inspektimin e gjendjes në terren. Për aplikantët që nuk i plotësojnë kushtet, Komisioni përgatit Njoftim për mosmiratim.
- Në fazën e pestë, Komisioni përgatit propozim pranë kryetares së Qytetit të Shkupit për pagesën e mjeteve sipas Thirrjes publike.

5.2 Për kërkesat e pranuara dhe të përpunuara nga pika 5, nënpika 5.1 alineja 1, do të mbahet listë me të dhënat e mëposhtme:

- emri, mbiemri dhe adresa;
- data dhe ora e aplikimit të pranuar për Thirrjen publike.

5.3 Pagesa e mjeteve të miratuara do të realizohet në përputhje me faturën e depozituar në origjinal të vërtetuar nga kontraktuesi.

6. Mënyra e realizimit të së drejtës për subvencion

6.1 Kryetarja e Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, sjellë Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare.

6.2 Komisioni njofton aplikantët, kërkesat e të cilëve janë refuzuar si të pa kompletuara, të vonuara dhe që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në përputhje me pikën 3 të Thirrjes publike.

Nr. _____

SHKUP